



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.44

2006

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.237, datë 12.4.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.560, datë 23.10.2000 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e projektit pilot për përfshirjen e spitalit të Durrësit në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”..... 1359
Vendim i KM nr.238, datë 28.4.2006	Për kalimin e disa mjediseve të ndërmarrjes elektroteknike, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit..... 1362
Vendim i GJK nr.7, datë 28.4.2006	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.14, datë 19.12.2005 dhe nr.15, datë 27.12.2005 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për një ndryshim në vendimin nr.166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë””, si antikushtetuese 1364
Vendim i GJK nr.8, datë 2.5.2006	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.64, datë 25.6.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues..... 1365
Vendim i KKRT nr.445, datë 27.4.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Dardan”..... 1369
Vendim i KKRT nr.446, datë 27.4.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Lezha”..... 1369
Vendim i KKRT nr.447, datë 27.4.2006	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv vendor “TV 6+1”..... 1370
Vendim i KKRT nr.448, datë 27.4.2006	Mbi licencën e subjektit televiziv kabllor “TV ALFA”..... 1370

Vendim i KKRT
nr.449, datë 27.4.2006

Mbi ndryshimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv
kabllor privat “Al-
TE”

1371

VENDIM
Nr.237, datë 12.4.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.560, DATË 23.10.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT PILOT PËR PËRFSHIRJEN
E SPITALIT TË DURRËSIT NË SKEMËN E SIGURIMEVE TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24 dhe 36 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.560, datë 23.10.2000 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Statuti i spitalit të Durrësit, që i bashkëlidhet vendimit, të zëvendësohet me statutin, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në pikën 3 të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Paragrafi i tretë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“- Spitali financohet nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, sipas kontratës së lidhur ndërmjet tyre. Në kontratë përcaktohen:

a) Paketa e shërbimeve me “njësitë” e parashikuara për çdo shërbim.

b) Vëllimi minimal dhe maksimal i punës.

c) Mënyrat e mbajtjes së të dhënave dhe të raportimit.

ç) Mënyra e llogaritjes së kostos.

d) Pagesat për shërbimet.

dh) Treguesit e monitorimit të cilësisë.

e) Mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

Burime të tjera financimi për spitalin e Durrësit janë fondet e krijuara nga të ardhurat dytësore dhe dhurimet e mundshme. Investimet kapitale mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë.”.

ii) Fjalja e dytë, e paragrafit të shtatë, shfuqizohet.

iii) Paragrafi i tetë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“- Spitali zbaton normat minimale, detyruesisht të respektueshme, të vendosura dhe të miratuara nga Ministri i Shëndetësisë për numrin e personelit, për përdorimin e materialeve të buta, të lëndëve djegëse dhe të ushqimit.”.

iv) Paragrafi i nëntë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“- Spitali zbaton tarifat për shërbimet me pagesë, të përcaktuara në vendimin nr.527, datë 1.11.1993 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e çmimeve në sistemin e shërbimit shëndetësor”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore, të nxjerra nga Ministri i Shëndetësisë. Qëllimi, mënyra dhe masa e përdorimit të të ardhurave dytësore, të realizuara nga spitali, caktohen nga bordi.”.

v) Paragrafi i njëmbëdhjetë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“- Ministria e Shëndetësisë ushtron kontroll mbi veprimtarinë, teknike e mjekësore, të spitalit dhe në zbatimin e investimeve publike. Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor ushtron kontroll në spitalin e Durrësit, për veprimtarinë financiare dhe për çështjet e parashikuara dhe të shprehura, në mënyrë të qartë, në kontratën e lidhur.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STATUTI I SPITALIT DURRËS

Neni 1

Spitali i Durrësit është person juridik publik, në kuptim të nenit 25 të Kodit Civil, me qendër në Durrës.

Neni 2

Spitali, si institucion i shërbimit shëndetësor publik, është jofitimprurës. Spitali ushtron veprimtarinë e tij sipas ligjit bazë të shërbimit shëndetësor, si edhe të ligjit të shërbimit spitalor në Republikën e Shqipërisë. Infrastruktura fizike dhe pajisjet e këtij spitali janë pronë e Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 3

Spitali drejtohet nga Bordi dhe drejtori i spitalit. Bordi është organi më i lartë ekzekutiv i spitalit.

Neni 4

Bordi i spitalit përbëhet nga 9 anëtarë. Përbërja e tij është si më poshtë:

- 1 përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë;
- 1 përfaqësues i DSHP-së Durrës;
- 1 përfaqësues i prefekturës;
- 1 përfaqësues i shoqatës së biznesmenëve Durrës;
- 2 përfaqësues të ISKSH-së;
- 1 përfaqësues i Urdhrit të Mjekut;
- 1 përfaqësues i shoqatës së pacientëve;
- 1 përfaqësues nga sindikata më e përfaqësuar për shëndetësinë në Durrës;
- Drejtori i spitalit (pa të drejtë vote).

Mbledhjet e Bordit janë të hapura. Bordi mund të thërrasë në mbledhjet e tij të gjithë drejtuesit e spitalit dhe/ose specialistë, ekspertë të tjerë jashtë spitalit, për çështje të ndryshme.

Neni 5

Secila nga organizatat apo institucionet e përmendura, caktojnë përfaqësuesit e tyre në Bord. Periudha e përfaqësimit në Bord është 3 vjet. Anëtarët e Bordit kanë të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se dy herë radhazi.

Neni 6

Kryetari i Bordit është përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë. Nënkryetari zgjidhet nga Bordi me votim të fshehtë.

Neni 7

Mbledhja thirret nga kryetari i Bordit dhe njoftohet me shkrim të paktën 7 ditë përpara duke bërë të ditur dhe rendin e ditës. Drejtori i spitalit ka të drejtë të kërkojë mbledhjen e Bordit, kur gjykon se kërkohen vendime të shpejta që nuk janë në kompetencën e tij. Kur mbledhja thirret nga drejtori, kriteri i afatit nuk zbatohet.

Neni 8

Mbledhja zhvillohet kur janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve, në rast të kundërt mbledhja shtyhet për ditën tjetër, duke përsëritur lajmërimin. Në këtë rast, mjafton një e dyta e anëtarëve.

Për mbledhjen e Bordit mbahet procesverbal nga një person i përhershëm i autorizuar nga kryetari.

Vendimet e Bordit nënshkruhen nga kryetari dhe depozitohen në spital.

Bordi mbledhet jo më pak se 4 herë në vit.

Neni 9

Vendimet e Bordit merren me shumicë votash. Çdo anëtar i Bordit ka të drejtën e një vote. Kur votat barazohen, vota e kryetarit është vendimtare.

Neni 10

Nënkryetari i bordit ushtron të drejtat e kryetarit në mungesë të tij.

Neni 11

Anëtarët e Bordit për pjesëmarrje në çdo mbledhje, marrin shpërblim sipas akteve të Këshillit të Ministrave.

Neni 12

Funksionet e Bordit janë:

a) Përgjigjet për zbatimin e politikave shëndetësore dhe udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë në spitalin e Durrësit.

b) Mbikëqyr dhe kontrollon drejtimin e veprimtarisë së spitalit.

c) Është përgjegjës për cilësinë e shërbimit.

d) Propozon Ministrisë së Shëndetësisë emërimin dhe shkarkimin e drejtorit, si edhe të nëndrejtorëve të spitalit.

e) Emëron shefat e shërbimeve.

f) Ngarkon drejtorin e spitalit të negociojë me ISKSH/DRSKSH-në Durrës projekt kontratën.

g) Miraton projektin e kontratës që lidhet midis spitalit dhe DRSKSH-së Durrës.

h) Miraton çdo vit raportin vjetor, bilancin, buxhetin vjetor dhe planin perspektiv 3-vjeçar të spitalit të paraqitur nga drejtori i spitalit.

i) Miraton mënyrën e përdorimit të të ardhurave, me nxjerrjen e rezultatit financiar.

j) Kontrollon zbatimin e normave të vendosura dhe të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me numrin e personelit.

k) Miraton çdo ndryshim në strukturën organizative të spitalit, përfshirë rastet kur nevojiten ndryshime në numrin e personelit.

l) Kontrollon e miraton zbatimin e rregullave dhe të procedurave të punësimit.

m) Kontrollon zbatimin e normave të përdorimit të materialeve të buta, të lëndëve djegëse dhe të ushqimit.

n) Harton dhe miraton rregulloren e funksionimit të Bordit.

o) Harton dhe i paraqet për miratim Ministrisë së Shëndetësisë rregulloren e funksionimit teknik të spitalit.

p) Raporton te Ministri i Shëndetësisë për veprimtarinë e përgjithshme të spitalit.

Neni 13

Bordi i delegon drejtorit të spitalit përgjegjësitë e menaxhimit të spitalit. Marrëdhëniet midis Bordit dhe drejtorit rregullohen me firmosjen e një kontrate njëvjeçare. Në kontratë vendosen objektiva specifike, si edhe përcaktohen qartë detyrat e përgjegjësitë e drejtorit.

Neni 14

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të spitalit:

- a) Drejtori i spitalit përfaqëson spitalin në marrëdhënie me të tretët. Ai është titullari ekzekutiv që drejton, organizon dhe ka të drejtë të ushtrojë kontroll mbi veprimtarinë e spitalit.
- b) Raporton e përgjigjet para Bordit për veprimtarinë e spitalit, si të kërkohet nga Bordi.
- c) I paraqet Bordit për miratim projektbuxhetin (të hartuar në bashkëpunim me Komisionin Mjekësor të spitalit), raportin vjetor dhe bilancin financiar.
- d) I propozon Bordit planin e trajnimeve për lidhjen e kontratës midis këtij të fundit dhe DRSKSH-së Durrës, kontratë kjo që përcakton spitalin dhe DRSKSH-në si palë.
- f) Ndjek realizimin e treguesve tekniko-ekonomikë të spitalit.
- g) Nënshkruan të gjitha aktet dhe kontratat që angazhojnë spitalin ndaj subjekteve ose personave të tjerë juridikë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Miraton dokumentacionin dhe zbatimin e kontratave të prokurimit publik sipas ligjit në fuqi.

Neni 15

Problemet që nuk janë përcaktuar në këtë statut, rregullohen me vendime të Bordit të spitalit brenda dispozitave ligjore dhe kompetencave që i janë dhënë këtij Bordi.

VENDIM

Nr.238, datë 28.4.2006

PËR KALIMIN E DISA MJEDISEVE TË NDËRMARRJES ELEKTROTEKNIKE, TIRANË, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË DHE KALIBRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, dhe të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin e disa mjediseve të godinës 2-katëshe silicate, me sipërfaqe totale 2209 m², deri tani në administrim të Ndërmarrjes Elektroteknike, Tiranë, në përgjegjësinë e administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky kalim të pasqyrohet në regjistrat përkatës të Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit, Ndërmarrja Elektroteknike, Tiranë dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.7, datë 28.4.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 13.03.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.20 Akti që i përket:

KËRKUES: PARTIA “LËVIZJA SOCIALISTE PËR INTEGRIM”, përfaqësuar nga zoti Spartak Braho, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR: KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga zotërinjtë Dritan Devole e Idar Bistri, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese të vendimeve nr.14, datë 19.12.2005 dhe 15, datë 27.12.2005 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për një ndryshim në vendimin nr.166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë””.

BAZA LIGJORE: Nenet 131/a e 134/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesi, ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve të mësipërme:

1. Shkelet parimi kushtetues për shkarkimin e organeve kushtetuese, nëpërmjet votimit të fshehtë, sepse ngatërrohet shqyrtimi i Raportit të Komisionit Hetimor me votimin e Kuvendit, për kërkesën e paraqitur për shkarkim;

2. Pavarësisht se Rregullorja e Kuvendit nuk quhet ligj, në kuptim të nenit 6 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, është akti bazë i këtij organi, prandaj duhet të miratohet me procedurë normale dhe jo me atë të përshpejtuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuarit, të subjektit të interesuar,

VËREN:

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, kërkuesi me shkresën nr.418, datë 21.04.2006, drejtuar Gjykatës Kushtetuese, njofton heqjen dorë nga kërkesa, për shpalljen si antikushtetuese të vendimeve nr.14, datë 19.12.2005 dhe nr.15, datë 27.12.2005 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se duhet të vendoset pushimi i gjykimit të çështjes.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenet 131/a të Kushtetutës; nenit 1/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe nenit 299/b të Kodit të Procedurës Civile, njëzëri,

VENDOSI:

- Pushimin e gjykimit të çështjes.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**VENDIM
Nr.8, datë 2.5.2006**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Alfred Karamuço	Anëtar i Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 06.02.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.16 Akti që i përket:

KËRKUES: EQEREM, ZYHDI, HILMI, ISLAM SHIJAKU; TEUTA HOXHA; KADRIJE HASHO; KUDRETE DISHNICA, përfaqësuar nga avokatët Arqile Nini e Dilaver Kambo, me autorizim.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. BASHKIA TIRANË, përfaqësuar nga juristja Natasha Kondi, me autorizim.
2. AGIM SULÇE, ZIHNI CUKALLA, KRISTUL BECI, DINE ABAZI, LUAN DAULLE, përfaqësuar vetë dhe nga Agim Sulçe e Zihni Cukalla.
3. ADRIATIK KALLULLI, KUJTIM SHESHI, ASTRIT SHABANI, THOMA BECI, LUTFI PEÇI, ALI KAZA, ASTRIT NANO, AGIM BALLA, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.64, datë 25.06.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33/1 e 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesit, kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë:

- Nuk u është komunikuar kërkesa për rishikim sipas nenit 447 të Kodit të Procedurës Civile.
- Vendimi është marrë në dhomën e këshillimit kur duhej të shqyrtohej në seancë gjyqësore në prani të palëve dhe t’u jepej mundësia të shprehnin pretendimet e kundërshtimet e tyre për provën e re. Subjektet e interesuara, kanë parashtruar këto shkaqe për mospranimin e kërkesës:
- Në këtë çështje nuk duhej të investohej Gjykata Kushtetuese, sepse gjykimi vazhdon. Rigjykimi në apel do t’u krijojë mundësitë palëve të parashtrojnë pretendimet e tyre.

- Parimi i kontradiktoritetit në gjykim nuk mund të zbatohet në seancën e rishikimit në Gjykatën e Lartë, sepse atje nuk kemi shqyrtim të një padie që i nënshtrohet pretendimeve të palëve.

- Vendimi i Gjykatës së Lartë për rishikim nuk është marrë në dhomën e këshillimit, por në seancë të rregullt gjyqësore ku është bërë vetëm vlerësimi nëse prova e re i plotëson kriteret për kthimin e çështjes për rigjykim.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuarve që kërkojnë pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara që kërkojnë rrëzimin e kërkesës dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.6623, datë 31.07.1996, ka vendosur rrëzimin e padisë së subjekteve të interesuara Agim Sulçe etj., ngritur kundër kërkuarve Eqerem Shijaku etj. dhe Bashkisë Tiranë, për kundërshtimin dhe pavlefshmërinë juridike të aktit administrativ nr.1358, datë 14.08.1992, me të cilin, këtyre të fundit u është njohur pronësia dhe u është kthyer pallati i banimit nr.7, ndodhur në Rrugën “Vaso Pasha”, Tiranë. Ky vendim, pas rigjyqimit, është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.13, datë 17.11.1998 dhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.271, datë 10.03.2000. Mbi rekursin në interes të ligjit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.12, datë 17.01.2002, kanë vendosur lënien në fuqi të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Pas vendimit të Kolegjeve të Bashkuara, subjektet e interesuara, kanë kërkuar rishikimin e vendimit duke pretenduar se kanë zbuluar prova të reja dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.64, datë 25.06.2004, ka prishur vendimin nr.13, datë 17.11.1998 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim në po atë gjykatë duke pezulluar edhe ekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

Në çështjen në shqyrtim Gjykata Kushtetuese konfirmon edhe një herë qëndrimet e mbajtura në vendimin e saj nr.17, datë 18.07.2005, lidhur me legjitimitimin e palëve për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, njoftimin e kërkesës për rishikim palës tjetër, si dhe për dëgjimin e tyre në seancë gjyqësore.

1. Në kundërshtim me pretendimet e subjekteve të interesuara, Gjykata Kushtetuese arrii në përfundimin se kërkuarët kanë të drejtë t'i drejtohen e ta vënë në lëvizje këtë Gjykatë për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.64, datë 25.06.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Sipas nenit 134/1 shkronja “g” të Kushtetutës në lidhje me nenin 131/f të saj, individët legjitimohen të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e ankesave të tyre nëse këto ankesa përmbajnë pretendime për një proces jo të rregullt ligjor dhe nëse ankuesit i kanë shterrur të gjitha mjetet e tjera juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Nga vlerësimi i rrethanave të çështjes, rezulton se pretendimet e kërkuarve kanë të bëjnë me një vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili, sipas tyre, jo vetëm ka prishur një vendim të një procesi gjyqësor të mëparshëm të përfunduar, por edhe se shkelja e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt nga Gjykata e Lartë nuk mund të riparohet në rigjykimet e çështjes.

Kërkesa për rishikimin e një vendimi të formës së prerë është një mjet i jashtëzakonshëm që pas ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile të vitit 2001 nuk shqyrtohet fillimisht nga gjykata e rrethit, por drejtpërdrejt nga Gjykata e Lartë dhe si rrjedhojë pala në proces, e cenuar nga prishja e vendimit, nuk ka asnjë mundësi e mjet procedural brenda juridiksionit gjyqësor të kundërshtojë prishjen nga kolegji civil dhe të kërkojë respektimin e të drejtave që rrjedhin nga vendimi i formës së prerë.

Jurisprudenca kushtetuese nuk i konsideron të shterrura mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese në rastet kur shqyrtimi i çështjes nuk ka përfunduar, po vazhdon pas kthimit të saj për rigjykim, sepse pretendimet për cenimin e parimeve kushtetuese të procesit në marrjen e provave e zbatimin e ligjit do të marrin përgjigje gjatë rigjyqimit të çështjes. Po në rastin në shqyrtim Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e formës së prerë që i takon një procesi tashmë të përfunduar duke vendosur kthimin për rigjykim dhe pezullimin e zbatimit të atij vendimi.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke pranuar kërkesën për rishikimin e çështjes jo vetëm e pranoi kërkesën e provat e paraqitura, por bëri edhe vlerësimin e tyre në raport me kërkesat e nenit 494/a të Kodit të Procedurës Civile. Ai jo vetëm i konsideroi ato prova të reja dhe që kanë lidhje me zgjidhjen e mëparshme të çështjes, por arrii edhe në përfundimin që këto prova nuk mund të dihen nga palët gjatë gjyqimit të mëparshëm të çështjes. Për këtë gjykim dhe për këto konkluzione të Gjykatës së Lartë, kërkuarësi nuk ka mjet tjetër ankimi të efektshëm për të kundërshtuar cenimin e

parimeve të një procesi të rregullt që ka sjellë si pasojë prishjen e vendimit.

Në këto rrethana, duke u nisur nga sa më sipër dhe nga fakti që rishikimi është mjet i jashtëzakonshëm e vendimi i Gjykatës së Lartë për prishjen është përfundimtar në sistemin gjyqësor, duhet të pranohet që kërkuarve u janë shterur të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tyre, prandaj ata legjitimohen të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për të kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

2. Nga zhvillimi i gjykimit rezultoi e provuar se Gjykata e Lartë ka pranuar për shqyrtim kërkesën e subjekteve të interesuara, por nuk u ka komunikuar kërkuarve një kopje të kësaj kërkesë. Jo vetëm kaq, por nga vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë rezulton se kërkesa për rishikim është shqyrtuar drejtpërdrejt në seancë gjyqësore dhe është vendosur pranimi i kërkesës, prishja e vendimit nr.13, datë 17.11.1998 të Gjykatës së Apelit Durrës, kthimi i çështjes për rigjykim dhe pezullimi i ekzekutimit të këtij vendimi, por pa u thirrur kërkuar dhe pa u dëgjuar ata, megjithëse ishin palë në vendimin e cenuar.

Në gjithë këtë proces, Gjykata Kushtetuese konstaton cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

E drejta për t'u njoftuar për ankimin dhe për të mësuar për argumentet e faktet e parashtruara në të është pjesë e së drejtës së individit për një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet së cilës atij do t'i krijohen mundësitë për të përgatitur mbrojtjen e vet dhe për të parashtruar argumentet e veta për pretendimet e palës tjetër. Vetë Kodi i Procedurës Civile në pjesën e tretë të tij (Ankimet dhe mënyra e gjykimit të tyre) dhe sidomos në nenin 442 të tij e përcakton kërkesën për rishikim si një mjet ankimi, ndërsa në nenin 447 nuk e përjashton atë nga detyrimi që ka gjykata për t'ia njoftuar atë palës tjetër pavarësisht nga fakti nëse çështja do të shqyrtohet në dhomën e këshillimit apo do të kalojë për shqyrtim në seancë gjyqësore.

3. Parimi i "procesit të rregullt gjyqësor" ka si element të vetin edhe të drejtën e secilës palë për të qenë e pranishme në seancë gjyqësore. Jurisprudenca kushtetuese dhe praktika e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut kanë përcaktuar standarde edhe për pjesëmarrjen në gjykim, me qëllim që t'i krijohen mundësitë secilës palë për të mbrojtur efektivisht të drejtën që pretendohet si e shkelur.

Nga përmbajtja e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile për rishikimin, si dhe nga vetë vendimi nr.1, datë 31.01.2006 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që kanë interpretuar ato dispozita, rezulton se kërkesa për rishikimin e një vendimi civil të formës së prerë shqyrtohet nga kolegji civil, në dhomën e këshillimit, pa pjesëmarrjen e palëve. Nga përmbajtja e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, rezulton gjithashtu se gjykata verifikon fillimisht nëse janë rastet e rishikimit, nëse është bërë nga ata që e kanë këtë drejtë, nëse është në tërësi e mbështetur në ligj e në prova e nëse janë kriteret ligjore për shqyrtim. Por, kjo e fundit, pra dhoma e këshillimit, është një organizëm që nuk mund të shërbejë për prishjen e vendimeve të formës së prerë, aq më tepër kur ai i ka kaluar të gjitha shkallët e shqyrtimit, por vetëm për seleksionimin e tyre d.m.th. për verifikimin nëse janë paraqitur shkaqe për kalimin në seancë. Nëse kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, dhoma e këshillimit vendos mospranimin e kërkesës për rishikim. Por nëse këto kriterë plotësohen, gjykata nuk mund të vendosë drejtpërdrejt prishjen e vendimit pa respektuar parimet kushtetuese të dëgjimit të palëve e të barazisë së mjeteve. Një vendim i tillë është pranuar edhe nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. "Kushdo qoftë në procesin penal, qoftë në procesin civil duhet të ketë mundësinë t'i paraqesë gjykatës, në mënyrën e duhur, çështjen e vet, në kushte që nuk e vendosin atë në situatë dukshëm të pafavorshme në raport me palën kundërshtarë".¹

Në çështjen objekt shqyrtimi është vendosur prishja e vendimit të formës së prerë, nëpërmjet kërkesës për rishikim, që është një mjet i jashtëzakonshëm. Megjithëse shqyrtimi është bërë në seancë gjyqësore, ku janë vlerësuar dobishmëria dhe rëndësia e provave të paraqitura nga njëra palë, nuk është njoftuar pala tjetër të marrë pjesë në gjykim dhe të japë mendimet e veta për këto prova dhe për ndikimin që ato duhet të kenë në cenimin e vendimit të formës së prerë. Në këtë mënyrë prishja e vendimit të formës së prerë është bërë duke vënë në situatë krejtësisht të pafavorshme palën, në favor të së cilës ishte dhënë vendimi dhe duke cenuar ekuilibrin që duhet të kenë ato në proces.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në vendimin nr.17, datë 18.07.2005, duke iu

¹ "Domba Beheer B.V. kundër Holandës", datë 27.10.1993.

referuar praktikës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut,² ka pranuar se e drejta për një proces të rregullt përfshin gjithashtu edhe nocionin se të dyja palët në proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë për palët të kenë njohuri edhe për komentet mbi provat e nxjerra. Ajo ka pranuar gjithashtu se duke marrë parasysh natyrën e shqyrtimit të çështjeve në rishikim që ka të bëjë jo vetëm me konstatimin e fakteve, por edhe me vlerësimin e tyre, ky vlerësim duhet të bëhet mbi bazën e parimit të barazisë së armëve apo kontradiktoritetit në gjykim.

Pjesëmarrja e palëve në gjykim, dëgjimi i pretendimeve të tyre për provat e interpretimin e ligjit në çështjen konkrete, garantohet nga neni 42 i Kushtetutës e neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, sepse kjo pjesëmarrje shërben për të mbrojtur në substancë të drejtat e secilës palë. Jo vetëm kaq, por krijimi i kushteve për të bërë një mbrojtje efektive është jo vetëm në interes të palëve, por edhe në interes të drejtësisë.

Në çështjen në shqyrtim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancë gjyqësore, ka shqyrtuar kërkesën me argumentet dhe provat e paraqitura nga një palë dhe ashtu siç pranojnë vetë kërkuarit është bërë shqyrtimi i kërkesës për rishikim mbi bazën e një dokumenti - provë e re. Por vendimi objekt shqyrtimi ka cenuar një gjendje juridike të krijuar dhe të drejta të fituara të cilat duhet të respektohen si nga shteti ashtu edhe nga individët. Këto të drejta nuk mund të mohohen dhe as të vihen në dyshim me arsyetimin se është paraqitur një provë e re nëqoftëse nuk respektohen parimet kushtetuese ndërmjet të cilave është edhe dëgjimi i pretendimeve të palës tjetër për provat e paraqitura. Çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt” përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Prandaj, respektimi i parimit kushtetues të procesit të rregullt nuk mund të pranohet se fillon vetëm në rigjykimin e çështjes në gjykatën e rrethit. Përkundrazi, ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku kërkohet të cenohen të drejtat e fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.64, datë 25.06.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr.445, datë 27.4.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV DARDAN”

Në mbështetje të pikës 21 të nenit 7, neneve 22, 23, 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, të vendimit nr.397, datë 30.11.2005 të KKRT-së, të Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

² Çështja Ruiz Mateos kundër Spanjës, datë 23.06.1993.

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.002/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, subjektin “Dardani” sh.p.k. për televizionin “TV Dardan”.

2. Të miratojë ndryshimet e të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës nga ana e televizionit vendor Dardan.

3. Zona e licencimit e subjektit “TV Dardan” është prefektura Elbasan, rrethi Tiranë dhe rrethi Durrës.

4. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi në datën 9.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.446, datë 27.4.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV LEZHA”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të vendimit nr.426, datë 21.3.2006 të KKRT-së, të Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.030/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, personin fizik z.Fred Stakaj për televizionin “TV Lezha”.

2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.

3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 3.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.447, datë 27.4.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV 6+1”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të vendimit nr.433, datë 21.3.2006 të KKRT-së, të Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.005/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin “6+1 Vlora” sh.p.k. për

televizionin “TV 6+1”.

2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 9.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.448, datë 27.4.2006

MBI LICENCËN E SUBJEKTIT TELEVIZIV KABLLOR “TV ALFA”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 nenit 22, nenit 30 dhe nenit 124 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i heqë licencën shoqërisë “Alfa” sh.p.k. për televizionin kabllor privat ALFA në qytetet Shkodër dhe Tiranë.
2. Licencat nr.002/RTVK dhe nr.007/RTVK bëhen të pavlefshme.
3. T’i japë subjektit, shoqërisë “Alfa Kabëll” sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Shkodrës, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të licencës, për të penetruar në qytetet Tiranë e Shkodër.
4. Në aneksin e licencës jepen kushtet e saj, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

VENDIM
Nr.449, datë 27.4.2006

MBI NDRYSHIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT TELEVIZIV KABLLOR PRIVAT “AL-TE”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, si dhe të vendimit të KKRT-së nr.277, datë 29.10.2004 “Për dhënie licence për televizionin kabllor privat AL-TE”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e zonës së licencimit të shoqërisë “Alte Kabllor” sh.p.k., stacioni televiziv kabllor privat “AL-TE”, me nr.licence 020/RTVK.
2. Zona e licencimit të TV AL-TE, sipas pikës 1 të këtij vendimi, është qyteti Durrës, qyteti Laç dhe qyteti Gjirokastrë.

3. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve e saj.

4. Ngarkohet Departamenti Teknik, Departamenti Ekonomik dhe Departamenti Juridik dhe i Licencave për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

Botime të reja

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Hyri në shtyp më 8.5.2006
Doli nga shtypi më 10.5.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi 100 lekë